



Prishtinë, 11 nëntor 2010
Kodi i ZRRE-së: V_294_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.2004/9), të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Nenin 21.6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr.2004/10);
- Shkresën e KEK sh.a lidhur me marrëveshjen për blerje të energjisë elektrike që prodhohet nga Hidrocentrali Dikanc, KK Dragash, të lidhur mes KEK sh.a dhe Frigo Food Energy Invest L.L.C, me adresë rr “Hajdar Dushi” nr. a/3, Prishtinë,

në mbledhjen e mbajtur me datë 11 nëntor 2010, nxori këtë:

VENDIM

I. MIRATOHET marrëveshja për blerje të energjisë (MBE) elektrike që prodhohet nga Hidrocentrali Dikanc, komuna e Dragashit, e lidhur mes KEK sh.a dhe Frigo Foods L.L.C .

Arsyetim

ZRRE ka pranuar shkresën e KEK sh.a. me të cilën njoftohet për marrëveshjen për blerje të energjisë elektrike të lidhur mes KEK sh.a dhe Frigo Food Energy Invest L.L.C.

Shkresës i janë bashkangjitur Marrëveshja për blerjen e energjisë dhe Marrëveshja për dhënien me qira të hidrocentralit Dikanc të lidhura mes KEK sh.a dhe Frigo Food Energy Invest L.L.C, si dhe Studimin e fizibilitetit për rehabilitimin dhe zgjerimit të Hidrocentralit të Dikancit.

Gjatë vlerësimit të Marrëveshjes për blerjen e energjisë (MBE) të lidhura mes KEK sh.a dhe Frigo Food Energy Invest L.L.C, ZRRE ka vërejtur se ajo nuk është tërësisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. ZRRE me shkresën e datës 05 gusht 2010 ka kërkuar nga KEK-u që t'i eliminojë këto mangësi ligjore të MBA-së dhe pastaj këtë ta dërgojë në ZRRE për miratim.

KEK SH.A me datë 22 tetor 2010 ka dërguar në ZRRE për miratim Marrëveshjen për blerje të energjisë me plotësimet e kërkuara nga ZRRE.

ZRRE ka vlerësuar Marrëveshjen e dërguar, me ndryshimet e bërë në të sipas kërkesës së ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërbëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar